



01 Nr. 698/24 Dt. 08.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e furnizimit me karburant-naftë, për nevojat e Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së-dega në Prizren, të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së-dega në Prizren dhe për nevojat e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së-dega në Prizren (zhvillimi dhe kryerja e aktiviteteve përkatëse), kështu që, i lejohet furnizimi me karburant naftë-triska si në vijim:
 - 1.1. Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së-dega në Prizren, i lejohet furnizimi me karburant naftë-triska, në sasi prej 100 litra për muaj, përkatësisht 600 litra, për periudhën 6 (gjashtë muaj).
 - 1.2. Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së-dega në Prizren, i lejohet furnizimi me karburant naftë -triska, në sasi prej 100 litra për muaj, përkatësisht 600 litra, për periudhën 6 (gjashtë muaj).
 - 1.3. Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së-dega në Prizren, i lejohet furnizimi me karburant naftë-triska, në sasi prej 100 litra për muaj, përkatësisht 600 litra, për periudhën 6 (gjashtë muaj).
2. Furnizimi lejohet të bëhet te operatori ekonomik i cili bënë furnizimin e Komunës me karburante.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet :
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - ShVL të UÇK-së,
 - ShIL të UÇK-së,
 - SHFD të UÇK-së,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

